



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E SHËNDETËSISË
DHE MBROJTJES SOCIALE
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK

IShP – Departamenti i Epidemiologjisë dhe
Kontrollit të Sëmundjeve Infektive

GRIPË NË SHQIPËRI PËR SEZONIN 2018 -2019
JAVA 52 (24-30 DHJETOR 2018)

Buletini i Gripit nr.6

4 Janar 2019

PËRMBLEDHJE

Në këtë vëllim:

Përmbledhje	1
Prirja e IRS dhe IRP	3
Frekuenca e hasjes	3
Nr total i mostrave	4
Viruset e tjerë	5
Shpërndarja moshore	6
STRRA	7
STRRA moshore	8
IRA-pragu	11
Kurba epidemike	12
Info nga TESSY	13
Vaksinimi	14

Informacion kyç:

- Situata ne EURO-TESSY
- Përbërja e vaksinës
- STRRA

Përmbledhje

Nga të dhënat e raportimit sipas survejancës së infeksioneve akute respiratore të sipërme dhe të poshtme të sistemit ALERT, survejancës sentinel të sëmundjeve të ngjashme me Gripin (ILI) në rrethin e Tiranës, dhe survejancës së infeksioneve respiratore akute të rënda (SRRA) në spitalet kryesore në të gjithë vendin si dhe raportimit rutinë, vërejmë se kemi një rënie të lehtë në javën 52/2018 por aktiviteti i tyre ne lidhje me gripin mbetet i ulët.

Kontinenti European

Në javën 52/2018 në kontinentin European aktiviteti i gripit në Evropë paraqet një trend në ritje. 2 vende kanë raportuar aktivitet mesatar.

Ne këtë javë 233 (37%) nga 629 mostra të marra nga survejnca sentinel janë

konfirmuar me virusin e gripit nga të cilat (99.6%) ishin te tipit A and 1 (0.4%) te tipit B. **Nga nentipizimi i viruseve të tipit A, rezultojnë nentipet A(H1N1) pdm09 (43.7%) dhe A(H3N2) (52.7%).**

Që nga fillimi i sezonit mbizoterojnë viruset e tipit A (n = 1110, 98.1%) krahasuar me viruset e tipit B (n = 22, 1.9%). Nga 904 viruset e tipit A, 483 (53.4%) ishin A (H1N1) pdm09 dhe 421 (46.6%) ishin A (H3N2). Nga genotipizimi i 6 viruseve të tipit B, 5 ishin të linjës B / Yamagata.

Pacientët e shtruar në ICU në javën 52/2018 (n = 178), janë konfirmuar më shpesh me viruset e tipit A të gripit (176, 98.9%) krahasuar me viruet e tipit B (2, 1.1%).

Nga survejanca jo-sentinel kanë rezultuar 1714 mostra positive për virusin e gripit nga të cilat 98.9% janë të tipit A dhe 1.1% janë të tipit B. Mbas nëntipizimit të viruseve të tipit A 63.6% rezultuan A(H1N1)pdm09 dhe 36.4% A(H3N2). Nga genotipizimi i 8 viruseve të tipit B, 6 rezultuan të linjës B / Yamagata dhe 2 viruse B/Victoria.

Të dhënat nga 22 vende që raportojnë në projektin EuroMOMO treguan se vdekshmëria nga të gjitha shkaqet ishte në nivele të ulëta dhe të pritshme për këtë kohë të vitit.

Rekomandimet e OBSH-së mbi përbërjen e vaksinës së gripit për Hemisferin Verior gjatë sezonit 2018 - 2019 janë:


A/Singapore/INFIMH-16-0019/2016 (H3N2)-like virus;
B/Colorado/06/2017-like virus (B/Victoria/2/87 lineage);
A/Michigan/45/2015 (H1N1)pdm09-like virus;

dhe për vaksinë quadrivalente:

B/Phuket/3073/2013-like virus (B/Yamagata/16/88 lineage)


Në bazë të analizimeve të thelluara filogjenetike të viruseve të dërguara nga Qendra Kombetare e Gripit në ISHP në qendrën e references në Londër (Francis-Crick Institute), është vlerësuar se një shtam virusi A(H1N1)pdm09, i izoluar në qendrën tonë mund të jetë një virus kandidat për vaksinën e gripit të sezonit të ardhshëm të hemisferit verior.

1. PËRQINDJA E MOSTRAVE RESPIRATORE QË KANË REZULTUAR POZITIVE PËR VIRUSET E GRIPIT, SIPAS KONTINENTEVE



2. PRIRJA E INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP) NË JAVËT 40 – 52 TË VITIT 2017 DHE TË VITIT 2018.

NUMRI I RASTEVE.



Në javën e 52 të vitit 2018 vërehet një prirje në rënie i numrit të infeksioneve Respiratore të Sipërme dhe të Poshtëme dhe ky numër është 18% më i lartë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.


3. FREKUENCA E HASJES SË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME DHE TË POSHTËME” SIPAS RRETHEVE NË JAVËN 51 DHE 52 TË VITIT 2018.

INCIDENCA (RASTE/10.000)



Vërehet rritje e numrit të rasteve të IRA në disa rrethe të vendit

4. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE TË ARDHURA SIPAS JAVËVE DHE REZULTATI LABORATORIK



Prej javes 40 (1 - 7 Tetor 2018) deri ne javen 52 (24 - 30 Dhjetor) janë grumbulluar 166 mostra nazofaringeale nga qendrat e survejancës ILI dhe SRRA apo STRRA.


Perpara pranimi në laborator kryhet rregullisht monitorimi i cilësisë së mostrës sipas protokolleve standarte. Të gjitha mostrat e ardhura janë testuar me metodën molekulare të Real-Time RT PCR.

Nga testimi i tyre nuk është identifikuar asnjë rast pozitiv për virusin e gripit.

5. REZULTATI I TESTIMIT PËR VIRUSE TË TJERË RESPIRATORË

Sipas algoritmit të testimit, rastet negative për grip testohen për viruse të tjera respiratore me anë të metodës molekulare. Më poshtë paraqiten rezultatet për javët 40 deri 51. Vëmë re se për javën e 51, nga numri total i mostrave të grumbulluara dhe analizuara, 11 (30%) kanë rezultuar pozitive për viruse të ndryshëm respiratorë.

Virusi respirator sincicial përbën virusin kryesor respirator të izoluar gjatë këtyre javëve.




SHPËRNDARJA E REZULTATEVE PËR JAVËT 40 DERI 51

LLOJI I VIRUSEVE TË TJERË RESPIRATORË


Viruset e tjera respiratorë	Nr.	% Pozitivitetit
Rhinovirus	4	2.6
Coronavirus 43	8	5.2
Coronavirus 63	6	3.9
Coronavirus 229	1	0.6
Virusi respirator sincicial	23	14.9
Parainfluenza tip-2	2	1.3
Parainfluenza tip 3	3	1.9
Parainfluenza tip 4	1	0.6
Bocavirus	1	0.6
Enterovirus	2	1.3
Metapneumovirus	3	1.9
Negative	99	64.3
Total	153	100.0

6. SHPËRNDARJA E NUMRIT TOTAL TË RASTEVE SIPAS GRUP-MOSHËS



54 (33%) e mostrave i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç por vërehet se nga grup mosha 5-14 vjeç numri i mostrave mbetet i ulët.


7. SËMUNDJE E TEPËR E RËNDË RESPIRATORE AKUTE (STRRA)




Rasti klasifikohet si SRRA (Sëmundje e rëndë respiratore akute) sipas përkufizimit të OBSH dhe si STRRA (Sëmundje tepër e rëndë respiratore akute) sipas klasifikimit tonë për të gjitha rastet që kanë nevojë për shtrim në repartet e terapisë intensive dhe kanë nevojë për oksigjenim.

34 (32%) prej 105 pacientëve spitalorë kanë paraqitur komplikacione (STRRA)

8. SHPËRNDARJA E RASTEVE SRRA DHE STRRA SIPAS JAVËVE






9. SHPËRNDARJA E RASTEVE SRRA SIPAS GRUPMOSHËS



16 (23%) e mostrave SRRA i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç


10. SHPËRNDARJA E RASTEVE SRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES SË MOSTRËS



11. SHPËRNDARJA E RASTEVE STRRA SIPAS VENDIT TË MARRJES SË MOSTRËS**12. SHPËRNDARJA RASTEVE STRRA SIPAS GRUPMOSHËS DHE REZULTATI LABORATORIK**


24 (71%) e mostrave STRRA i përkasin grupmoshës pediatrike 0-14 vjeç

13. NUMRI TOTAL I MOSTRAVE SIPAS VENDIT TË MARRJES DHE REZULTATIT LABORATORIK



Numri më i madh i mostrave ka ardhur nga Qendra Shendetësore Nr. 2, ndjekur nga SUSM dhe Spitali Infektiv, QSUT.


14. KRAHASIMI I AKTIVITETIT TË “INFEKSIONEVE RESPIRATORE TË SIPËRME (IRS) DHE TË POSHTËME (IRP)” SIPAS SEZONEVE (JAVËT 40 – 20) DHE PRAGU EPIDEMIK. RASTE/100 000



Në javën 52 /2018 aktiviteti i IRA paraqet:

- prirje në rënie
- aktivitet gjeografik të përhapur
- intensitet të ulët
- impakt të ulët



15. KURBA EPIDEMIKE DHE INFEKSIONET RESPIRATORE SIPAS JAVËVE (IRA RASTE/100 000)



Vërehet që prirja e numrit të mostrave të marra ndjek prirjen e Infeksioneve respiratore (IRA)

16. INTENSITETI DHE PËRHAPJA GJEORAFIKE E GRIPIT DHE VIRUSET QË QARKULLOJNË NË RAJONIN EUROPIAN NË JAVËN 52.

<http://flunewseurope.org/>



Vaksinimi ndaj Gripit

Gjatë muajve të Tetorit dhe Nëntorit u krye trajnimi i personelit në lidhje me vaksinimin ndaj gripit dhe raportimet për të dhe më pas gjatë muajve Nëntor – Dhjetor u shpërndanë 50 mijë doza vaksine ndaj Gripit , Vaxigrip (inaktive) në flakone 10 dozësh. Grupet të cilat mund të vaksinoheshin me këtë vaksinë ishin: personeli shëndetësor, gratë shtatëzana, persona me sëmundje kronike si diabet, sëmundje kronike obstruktive pulmonare, sëmundje kronike të zemrës, veshkave, mëlçise etj. si dhe persona obezë apo me imunodeficiencë të të gjitha moshave.

Më poshtë në **Tabelën 1** paraqitet administrimi i kësaj vaksine sipas raportimeve të drejtorive të shëndetit publik. **Vetëm 5 drejtori nuk kanë raportuar ende në lidhje me vaksinimin ndaj gripit: Librazhdi, Tepelena, Hasi, Malësia e Madhe, dhe Delvina.**

Ndërsa drejtori si në **Kuçovë, Skrapar, Bulqizë, dhe Peqin e kanë administruar vaksinën 100%**. Ndërkohë drejtoritë e Beratit, Matit, Gramshit, Lushnjes, Mallakastrës, Përmetit, Pogradecit dhe Lezhës kanë administruar mbi 90% të vaksinave të marra. Drejtoritë e Fierit, Gjirokastrës, Korçës, Devollit, Kolonjës, Kukësit, Tropojës dhe Kurbinit kanë administruar 60-90% të sasive të marra të vaksinave.

Administrimi është tepër i ulët në Shkodër dhe mbetet po ashtu i ulët në Elbasan, Durrës, Dibër, Mirditë dhe Krujë.

Tabela 1. Administrimi i sasisë së parë të vaksinës ndaj Gripit


DRSH/DSHP	Sasia e vaksinës në doza (pjesa e parë)	Numri i vaksinimeve të kryera 9-21 Dhjetor	Perqindja e vaksinave të administruara	Shenime
Berat	1750	1619	93%	
Kucove	400	400	100%	
Skrapar	250	250	100%	
Diber	800	251	31%	Nuk kanë raportuar ende vaksinimet në popullatë
Mat	550	528	96%	
Bulqize	400	400	100%	
Durres	3000	646	22%	Nuk kanë raportuar ende vaksinimet në popullatë
Kruje	900	490	54%	
Elbasan	2600	471	18%	Nuk kanë raportuar ende vaksinimet në popullatë
Peqin	300	300	100%	
Librazhd	900			Nuk ka raportuar ende
Gramsh	350	321	92%	
Fier	3400	2084	61%	
Lushnje	1600	1556	97%	
Mallakaster	400	376	94%	
Gjirokastër	600	521	87%	
Permet	300	297	99%	
Tepelene	300			Nuk ka raportuar ende
Korçë	2800	2428	87%	
Pogradec	1600	1556	97%	
Devoll	600	395	66%	
Kolonje	300	234	78%	
Kukës	700	615	88%	
Has	300			Nuk ka raportuar me detaje, por kanë përfunduar
Tropoje	200	157	79%	
Lezhë	1300	1182	91%	
Kurbini	750	666	89%	
Mirdite	500	185	37%	Nuk kanë raportuar ende vaksinimet në popullatë
Shkodër	3300	319	10%	Nuk kanë raportuar ende vaksinimet në popullatë
M. Madhe	450			Nuk ka raportuar ende me detaje

Gjatë muajit Dhjetor u shpërndanë edhe 50 mijë doza të tjera vaksine gripi “Influenza Vaccine Split Virion” (inaktive) në flakone 1 dozë. Në tabelën 2 paraqiten sasitë e shpërndara nga sasia e dytë e vaksinës ndaj gripit.


Tabela 2. Pjesa e dytë e dozave të vaksines ndaj gripit të shpërndara në çdo DRSH/DSHP

DRSH/DSHP	Sasia e vaksinës në doza (pjesa e dytë)
Berat	1900
Kuçovë	500
Skrapar	450
Dibër	900
Mat	650
Bulqizë	500
Durrës	3000
Krujë	1100
Elbasan	2600
Peqin	400
Librazhd	1000
Gramsh	550
Fier	3600
Lushnje	1800
Mallakastër	500
Gjirokastër	800
Përmet	400
Tepelenë	400
Korçë	2800
Pogradec	1800
Devoll	700
Kolonjë	500
Kukës	800
Has	400
Tropojë	300
Lezhë	1500
Kurbin	850
Mirditë	1000
Shkodër	3500
M. Madhe	550
Pukë	450
Tiranë	8800
Kavajë	1000
Vlorë	3000
Sarandë	800
Delvinë	150


Më poshtë po paraqesim vaksinimin e personelit shëndetësor mjek dhe infermierë në qendrat shëndetësor sipas raportimeve të drejtorive të shëndetit publik.




Grafiku 1. Vaksinimi i personelit shëndetësor në qendrat shëndetësore të Beratit, Kuçovës, Skraparit, Dibrës, Matit, Bulqizës, Durrësit dhe Krujës.



Grafiku 2. Vaksinimi i personelit shëndetësor në qendrat shëndetësore të Elbasanit, Peqinit, Gramshit, Fierit, Lushnjes, Mallakastrës, Gjirokastrës dhe Përmetit.




Grafiku 3. Vaksinimi i personelit shëndetësor në qendrat shëndetësore të Korçës, Pogradecit, Devollit, Kolonjës, Kukësit, Tropojës, Lezhës, Kurbinut dhe Mirditës.




Grafiku 4. Vaksinimi i personelit shëndetësor në qendrat shëndetësore të Shkodrës, Pukës, Tiranës, Kavajës, Vlorës dhe Sarandës.

Nga grafikët shihet qartë rrethet të cilët e kanë mbulesën vaksinale të personelit të qendrave shëndetësore ndën 60% dhe sidomos ato ndën 50% si personeli mjek në Tiranë, Shkodër dhe Korçë dhe niveli shumë i ulët i vaksinimit për personelin mjekësor në **Skrapar**.


Ndërsa në grafikët e mëposhtëm po paraqesim vaksinimin e personelit shëndetësor në spitale për të parë më qartë nëse ka diferenca midis vaksinimit të personelit shëndetësor në spitale dhe në qendra shëndetësore.



Grafiku 5. Vaksinimi i personelit shëndetësor në spitalet e Beratit, Kuçovës, Skraparit, Matit, Bulqizes, Durrësit, Krujës, Peqinit, Elbasanit dhe Gramshit.



Grafiku 6. Vaksinimi i personelit shëndetësor në spitalet e Lushnjës, Mallakastrës, Përmetit, Korçës, Devollit, Kolonjës, dhe Tropojës.



Grafiku 7. Vaksinimi i personelit shëndetësor në spitalet e Lezhës, Kurbinit, Mirditës, Pukës, Shkodrës, Fierit, Sarandës, Vlorës dhe Kavajës.

**Departamenti i Epidemiologjisë dhe
Kontrollit të Sëmundjeve Infektive
INSTITUTI I SHËNDETIT PUBLIK**

Adresa:
Rr. "A. Moisiu" Nr. 80
Tiranë

Tel: + 355 42 374 756
Fax: + 355 42 370 058
www.ishp.gov.al
